

L I G J
Nr.7910, datë 5.4.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7503, DATË 26.7.1991 “PËR STATUSIN E
DEPUTETIT TË KUVENDIT POPULLOR”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7622, DATË
13.10.1992 DHE NR.7691, DATË 18.3.1993**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e deputetëve të Komisionit të Përhershëm të Kuvendit Popullor për Ekonominë, Buxhetin, Financat e Tregtinë,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 1 i ligjit nr.7691, datë 18.3.1993 “Për një ndryshim në ligjin nr.7503, datë 26.7.1991 “Për statusin e deputetit të Kuvendit Popullor”, ndryshuar me ligjin nr.7563, datë 11.5.1992, ndryshohet si vijon:

“Shpenzimet për bisedat e tij telefonike përballohen nga shteti 700 impulse në muaj”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij qysh nga data 1.3.1995.

Shpallur me dekretin nr.1067, datë 18.4.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha